



QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Provimet Kombëtare të Arsimit Bazë 2018

RAPORT PUBLIK

MBI

ARRITJET E NXËNËSVE

1 Hyrje

Matja e arritjeve të nxënësve, në përfundim të një niveli arsimor, shërben jo vetëm për të pasqyruar funksionimin e sistemit arsimor në kontekstin e politikave arsimore aktuale, por edhe për të ndërtuar politika të reja arsimore. Rezultatet e nxënësve përfaqësojnë treguesin kryesor të cilësisë dhe të performancës së sistemit arsimor, sidomos kur kjo lidhet me synimin për pajisjen e nxënësve me njohuri dhe me kompetenca për përballimin e kërkesave të kohës.

Raporti publik i Provimeve Kombëtare të Arsimit Bazë 2018 shërben për t'u siguruar politikëbërësve, përdoruesve dhe publikut informacion për rezultatet e nxënësve dhe për faktorët që ndikojnë në to. Ai synon të kontribuojë në zhvillimin dhe analizën e treguesve sasiorë krahasimorë të vlerësimit të jashtëm të arritjeve të nxënësve të klasës IX.

Informacioni është i organizuar në mënyrë të tillë që mundëson jo vetëm njohjen e arritjeve të nxënësve në nivel DAR/ZA, por njëkohësisht edhe krahasimin mes DAR/ZA, duke iu referuar edhe arritjeve në nivel kombëtar.

1.1 Metodologjia

Informacioni statistikor i këtij raporti është bazuar në databazën e krijuar nga QSHA, gjatë procesit të organizimit dhe realizimit të provimeve të Arsimit Bazë 2018. Baza e të dhënave përmban informacion statistikor në nivel nxënësi mbi arritjet në lëndët gjuhë shqipe, matematikë dhe gjuhë e huaj.

Fushat kryesore të bazës së të dhënave janë:

- DAR dhe ZA (së cilës i përket shkolla që ka ndjekur nxënësi),
- shkolla e ndjekur,
- gjinia e nxënësit,
- lloji i shkollës (publike/jopublike),
- vendndodhja e shkollës (fshat/qytet),
- kalueshmëria gjatë vitit shkollor,
- pikët e fituara në provim nga çdo nxënës,
- notat në provimet e arsimit bazë,
- notat vjetore të fituara nga nxënësit gjatë vitit shkollor (për lëndët e provimeve të arsimit bazë).

Të dhënat mbi arritjet mesatare të nxënësve për provimet e dhëna nga nxënësit në provimet e Arsimit Bazë 2018 janë paraqitur:

- në nivel kombëtar,
- në nivel DAR/ZA,
- sipas urbanizimit - fshat/qytet,
- sipas gjinisë - femra/meshkuj,
- sipas llojit të shkollës (publike/jopublike).

Në përpunimin statistikor të të dhënave, janë përfshirë të dhënat e arritjeve **të nxënësve** të vitit shkollor 2017-2018, të cilët morën pjesë në provimet e Arsimit Bazë 2018, sesioni i parë.

Përpunimi i të dhënave u realizua nëpërmjet software SPSS.

Informacioni statistikor i përftuar nga përpunimi është paraqitur në formë tabelare dhe/ose grafike.

Raporti përmban këta tregues statistikorë:

- Mesatarja e pikëve të fituara në testim,
- Nota mesatare Vjetore - (NV),

- Nota mesatare e provimit- (NM),
- Shmangia standarde - (*shmangia mesatare e të dhënave nga mesatarja e tyre*),
- Nota mesatare Vjetore në nivel kombëtar - (NVk),
- Nota mesatare e provimit në nivel kombëtar - (NMk),
- Kalueshmëria në provimin e Arsimit Bazë,
- Diferenca e Notës Vjetore me Notën Vjetore në nivel kombëtar - (NV – NVk),
- Diferenca e Notës së provimit me Notën e provimit në nivel kombëtar - (NM – NMk),

2 Statistika përmblledhëse për PKAB 2018

Tabela e mëposhtme 2-1, paraqet të dhëna statistikore përmblledhëse për provimet e PKAB-së 2018, për sesionin e parë. Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i nxënësve sipas lëndëve/provimeve të Arsimit Bazë 2018, të klasifikuar sipas kategorive: publik/privat, fshat/qytet, femra/meshkuj, arritjet e të cilëve janë përdorur për përgatitjen e këtij raporti.

Tabela 2-1: Të dhëna statistikore përmblledhëse për provimet e PKAB-së 2018

Nr.	Lënda	Numri i nxënësve që morën pjesë në provimin e Arsimit Bazë		
		Total	Publik	Privat
1	Gjuhë shqipe (Total)	36350	33801	2549
	Qytet	19565	17151	2414
	Fshat	16785	16650	135
	Femra	17744	16474	1270
	Meshkuj	18606	17327	1279
2	Matematikë (Total)	37406	34801	2605
	Qytet	19972	17496	2476
	Fshat	17434	17305	129
	Femra	18148	16864	1284
	Meshkuj	19258	17937	1321
3	Gjuhë e Huaj (Total)	34250	31951	2299
	Qytet	18389	16225	2164
	Fshat	15861	15726	135
	Femra	16630	15499	1131
	Meshkuj	17620	16452	1168

2.1 Statistika Krahase PKAB 2016 - 2018

Tabela e mëposhtme 2-2, paraqet të dhëna statistikore përmblledhëse për **PKAB 2016 -2018**.

Tabela 2-2: Të dhëna statistikore përmblledhëse për tri vitet e fundit

Nr.	Lënda	Numri i nxënësve që morën pjesë në provim			Kalueshmëria në provim	Nota mesatare në PKAB
		Total	Publik	Privat	(në %)	
2018						
1	Gjuhë shqipe	36350	33801	2549	99.76%	7.66
2	Matematikë	37406	34801	2605	99.57%	7.13
3	Gjuhë e Huaj	34250	31951	2299	97.50%	6.91
Të gjitha lëndët		107985	101462	6523	98.72%	7.39
2017						
1	Gjuhë shqipe	35541	33717	1824	99.50%	7.32
2	Matematikë	36522	34634	1888	98.90%	6.62
3	Gjuhë e Huaj	29330	27630	1700	99.50%	8.22
Të gjitha lëndët		101393	95981	5412	99.20%	7.39
2016						
1	Gjuhë shqipe	39176	34475	4701	98.90%	7.24
2	Matematikë	43987	40908	3079	97.60%	6.78
3	Gjuhë e Huaj	34921	32127	29557	99.40%	7.86
Të gjitha lëndët		118084	107510	37337	98.53	7.26

Nga krahasimi i të dhënave me PKAB-në e vitit të kaluar, në sesionin e parë për të gjitha lëndët rezulton se:

- kalueshmëria e nxënësve në provimet PKAB, ka një ulje prej 0.48% në krahasim me vitin e kaluar, por krahasuar me vitin 2016, ka ngritje me 0.19%.
- nota mesatare në dy vitet e fundit nuk ka ndryshim dhe rezulton më e lartë se mesatarja e vitit 2016. (diferenca 0.13 njësi notë).

3 Lënda: Gjuhë shqipe

3.1 Arritjet e Nxënësve


Tabela e mëposhtme paraqet pikët mesatare të fituara nga nxënësit e çdo DAR/ZA në provimin kombëtar të gjuhës shqipe.

Të dhënat e kësaj table janë paraqitur grafikisht në grafikun 3-1. Grafiku tregon mesataret e pikëve të secilës DAR/ZA, duke i krahasuar ato me mesataren e pikëve në nivel kombëtar.

Tabela 3-1: Arritjet mesatare për çdo DAR/ZA

Nr	DAR/ZA	Pikë mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare e provimit	Shmangia mesatare	Nota mesatare vjetore	Shmangia mesatare
Në nivel kombëtar		30.76	9.58	7.66	1.33	7.3	1.67
1	BERAT	29.38	7.97	7.46	1.12	7.51	1.73
2	BULQIZË	22.78	9.00	6.56	1.28	6.56	1.28
3	DELVINË	36.27	9.49	8.40	1.24	7.75	1.55
4	DEVOLL	34.73	8.65	8.21	1.22	7.44	1.81
5	DIBER	26.15	9.33	7.04	1.30	6.88	1.69
6	DURRËS	31.96	9.31	7.82	1.30	7.24	1.70
7	ELBASAN	30.44	9.81	7.60	1.33	7.02	1.69
8	FIER	30.00	9.19	7.56	1.29	7.24	1.69
9	GJIROKASTËR	34.21	9.38	8.10	1.30	7.52	1.75
10	GRAMSH	34.78	8.52	8.20	1.23	7.64	1.72
11	HAS	31.24	9.39	7.72	1.30	7.75	1.80
12	KAMËZ	28.77	8.44	7.37	1.19	6.94	1.60
13	KAVAJË	30.78	8.93	7.66	1.22	7.07	1.71
14	KOLONJË	34.68	10.05	8.20	1.41	7.43	1.70
15	KORÇË	32.47	9.09	7.90	1.30	7.39	1.76
16	KRUJË	29.26	8.72	7.46	1.22	7.35	1.73
17	KUÇOVË	26.81	9.27	7.12	1.29	7.13	1.62
18	KUKËS	29.44	8.27	7.52	1.17	6.96	1.69
19	KURBIN	33.93	8.47	8.06	1.18	7.57	1.72
20	LEZHË	30.90	8.73	7.65	1.23	7.19	1.62
21	LIBRAZHD	26.41	8.87	7.06	1.21	7.10	1.17
22	LUSHNJE	32.72	9.12	7.90	1.26	7.41	1.76
23	MALËSI E MADHE	28.90	9.15	7.39	1.29	7.05	1.74
24	MALLAKASTËR	32.66	8.24	7.94	1.10	7.31	1.67
25	MAT	24.98	9.06	6.87	1.31	7.02	1.69

26	MIRDITË	29.25	9.71	7.46	1.38	7.17	1.65
27	PEQIN	29.45	11.37	7.47	1.66	7.25	1.75
28	PËRMET	27.16	9.15	7.12	1.28	7.08	1.56
29	POGRADEÇ	33.13	10.64	7.97	1.54	7.58	1.72
30	PUKË	30.34	9.17	7.60	1.25	7.35	1.53
31	SARANDË	33.57	8.98	8.02	1.24	7.36	1.61
32	SHKODËR	30.58	9.18	7.63	1.28	7.17	1.70
33	SKRAPAR	25.98	8.48	7.04	1.21	6.82	1.55
34	TEPELENË	27.86	9.27	7.24	1.33	7.52	1.71
35	TIRANË	34.63	8.69	8.17	1.19	7.80	1.66
36	TIRANË QARK	28.02	8.64	7.30	1.23	7.22	1.60
37	TROPOJË	34.96	9.56	8.28	1.40	7.60	1.74
38	VLORË	24.69	9.47	6.81	1.35	6.81	1.35



Grafiku 3-2: Arritjet mesatare për çdo DAR/ZA

3.2 Arritjet në nivel kombëtar

- **mesatarja e pikëve** të fituara në provimin e Gjuhës shqipe është **30.76 pikë**, me shmangie mesatare 9.58;
- **nota mesatare e provimit** është 7.66 me shmangie mesatare 1.33;
- **nota mesatare vjetore** është 7.30 me shmangie mesatare 1.67.

Nga krahasimi i vlerave të notës mesatare vjetore me notën mesatare të provimit kombëtar të arsimit bazë, referuar nivelit kombëtar, rezulton se nota mesatare e provimit kombëtar është 0.36 njësi notë më e lartë se nota mesatare vjetore.

Tabela 3.2 paraqet arritjet mesatare të nxënësve në lëndën e Gjuhës shqipe. Arritjet e nxënësve janë dhënë në nivel kombëtar, sipas urbanizimit fshat/qytet, sipas gjinisë femra/meshkuj, si edhe sipas sistemit publik/privat të edukimit.

Tabela 3-2: Arritjet mesatare të nxënësve sipas kategorive

		Pikët e fituara në test		Nota e PKAB-së		Nota Vjetore	
Urbanizimi	Gjinia	Mesatarja	Shmangia	Nota	Shmangia	Nota	Shmangia
		e pikëve	mesatare	mesatare	mesatare	mesatare	mesatare
Në nivel kombëtar	Femra	33.97	8.68	8.09	1.21	7.94	1.54
	Meshkuj	27.69	9.38	7.25	1.31	6.69	1.57
	Total	30.76	9.58	7.66	1.33	7.30	1.67
Qytet	Femra	36.26	8.01	8.40	1.12	8.21	1.50
	Meshkuj	30.42	9.35	7.62	1.29	6.97	1.64
	Total	33.26	9.20	8.00	1.28	7.57	1.69
Fshat	Femra	31.33	8.69	7.73	1.21	7.62	1.53
	Meshkuj	24.47	8.34	6.81	1.19	6.35	1.41
	Total	27.84	9.18	7.26	1.28	6.97	1.60
Publik (në nivel kombëtar)	Femra	33.57	8.68	8.04	1.21	7.88	1.54
	Meshkuj	27.13	9.20	7.19	1.29	6.60	1.54
	Total	30.27	9.51	7.60	1.32	7.22	1.67
Qytet	Femra	35.82	8.07	8.35	1.13	8.13	1.52
	Meshkuj	29.77	9.27	7.55	1.29	6.85	1.62
	Total	32.70	9.22	7.94	1.28	7.47	1.70
Fshat	Femra	31.28	8.68	7.72	1.21	7.62	1.53
	Meshkuj	24.37	8.28	6.80	1.18	6.34	1.41
	Total	27.77	9.16	7.25	1.28	6.96	1.60

Privat (në nivel kombëtar)	Femra	39.19	6.84	8.80	0.99	8.72	1.27
	Meshkuj	35.25	8.42	8.26	1.18	7.81	1.53
	Total	37.21	7.92	8.53	1.12	8.27	1.48
Qytet	Femra	39.23	6.87	8.81	0.99	8.72	1.28
	Meshkuj	35.25	8.48	8.26	1.19	7.81	1.55
	Total	37.25	7.96	8.54	1.12	8.27	1.49
Fshat	Femra	38.32	6.36	8.66	0.96	8.77	1.09
	Meshkuj	35.29	7.63	8.24	1.16	7.79	1.35
	Total	36.57	7.25	8.41	1.10	8.21	1.33

3.2.1 Arritjet sipas gjinisë

Nga krahasimi i arritjeve mesatare të vajzave dhe djemve, në nivelin kombëtar, rezulton se:

- arritjet mesatare për vajzat janë më të larta, krahasuar me arritjet mesatare të djemve
- mesatarja e pikëve të fituara nga vajzat është rreth **6.28 pikë** më e lartë, krahasuar me mesataren e pikëve të fituara nga djemtë,
- nëse krahasojmë diferencat që ekzistojnë mes arritjeve të nxënësve në provim, me arritjet vjetore të tyre, rezulton se vajzat kanë marrë një vlerësim më të lartë në provimin e arsimit bazë, në raport me arritjet vjetore të tyre (nota mesatare në PKAB është 8.09, kundrejt 7.94 që është nota mesatare vjetore),
- pohimi i mësipërm mund të thuhet edhe për djemtë, ku nota mesatare në PKAB është 7.25, kundrejt 6.69 që është nota mesatare vjetore.

3.2.2 Arritjet sipas urbanizimit qytet/fshat

Nëse do të analizojmë arritjet e nxënësve në nivel kombëtar, sipas elementëve të urbanizimit qytet/fshat, rezulton se:

- ekzistojnë diferenca të konsiderueshme mes arritjeve të nxënësve që kanë ndjekur shkollën në qytet, kundrejt atyre që e kanë ndjekur shkollën në fshat,
- mesatarja e pikëve të fituara nga nxënësit e qytetit rezulton të jetë rreth **5.42 pikë** më e lartë kundrejt mesatares së pikëve të fituara nga nxënësit e fshatit,
- ekzistenca e diferencës prej **5.42 pikësh**, në mesataren e pikëve, pasqyrohet edhe në diferencën e notës mesatare të arsimit bazë mes dy kategorive, vlera e së cilës është me 0.74 njësi notë.

Në nivel kombëtar, diferencat e arritjeve midis kategorive Qytet dhe Fshat janë përkatësisht: për vajzat **4.93 pikë**, ndërsa për djemtë **5.95 pikë**.

- Për të tre treguesit statistikorë të tabelës 3.2 shihet se arritjet e vajzave në qytet janë më të larta kundrejt vajzave të fshatit.
- Nëse i referohemi arritjeve mesatare vjetore, vajzat e qytetit kanë një notë mesatare vjetore me një vlerë prej **0.59** më të lartë se vajzat e fshatit. Kjo diferencë, arrin deri në **0.67** njësi note, nëse i referohemi arritjeve në provimin kombëtar të arsimit bazë.
- Të njëjtën situatë kemi kur krahasojmë arritjet mesatare vjetore dhe të arsimit bazë për djemtë e qytetit kundrejt djemve të fshatit.

3.2.3 Arritjet sipas sistemit publik/jopublik të edukimit

Diferenca të mëdha dallohen edhe mes dy sistemeve arsimore (publik/jopublik) që ekzistojnë në vendin tonë. Nga të dhënat e tabelës 3.2 rezulton se:

- arritjet mesatare të nxënësve në sistemin jopublik të edukimit janë më të larta se arritjet mesatare të nxënësve në sistemin publik.
- kjo situatë qëndron si për mesataren e pikëve në provim, ashtu edhe për notën mesatare të provimit dhe atë vjetore.
- Të njëjtat dallime ekzistojnë edhe nëse krahasojmë arritjet e nxënësve femra/meshkuj në sistemin privat me arritjet e nxënësve femra/meshkuj në sistemin publik, si edhe për kategoritë fshat/qytet në privat kundrejt kategorive fshat/qytet në sistemin publik.

3.2.4 Qëndrueshmëria e arritjeve

Nëse do të analizojmë qëndrueshmërinë e arritjeve të nxënësve në provimin e arsimit bazë kundrejt arritjeve vjetore, duke krahasuar notën mesatare vjetore me notën mesatare të provimit shihet se:

- nxënësit e sistemit publik kanë shkallë më të lartë të paqëndrueshmërisë së arritjeve krahasuar me nxënësit e sistemit privat. Kjo situatë është e vlefshme për kategoritë: femra/ meshkuj, si dhe qytet/fshat.

Nga të dhënat e **Tabelës 3.2** rezulton se:


- në sistemin publik, arritjet mesatare në provimin e arsimit bazë janë **0.38** njësi notë më të larta kundrejt arritjeve mesatare vjetore të tyre, ndërkohë që për nxënësit e sistemit privat arritjet mesatare në provimin e arsimit bazë ndryshojnë me ato vjetore me një vlerë prej **0.26** njësi notë.

- në sistemin publik dhe atë jopublik arritjet e vajzave janë më të larta kundrejt arritjeve të djemve si për kategorinë fshat ashtu dhe për atë qytet.

Tabela 3-3 dhe **Grafiku 3-3**, japin shpërndarjen në përqindje të notave të provimit të arsimit bazë për lëndën e Gjuhës shqipe.

Tabela 3-3: Shpërndarja e notave të provimit të arsimit bazë

Sistemi i edukimit	Nota e PKAB në Gjuhë shqipe						
	4	5	6	7	8	9	10
Publik	0.24%	5.85%	13.90%	23.11%	25.61%	17.61%	6.68%
Jopublik	0.00%	0.09%	0.28%	0.84%	1.82%	2.65%	1.33%
Në nivel kombëtar	0.24%	5.94%	14.17%	23.95%	27.43%	20.26%	8.01%




Grafiku 3-3: Shpërndarja e notave të provimit të arsimit bazë

Tabela 3-4 dhe **Grafiku 3.2.4-4**, japin shpërndarjen e notave vjetore për lëndën e Gjuhës shqipe.

Tabela 3-4: Shpërndarja e notave vjetore

Sistemi i edukimit	Nota vjetore në Gjuhë Shqipe					
	5	6	7	8	9	10
Publik	18.89%	17.60%	16.09%	15.45%	13.63%	11.18%
Jopublik	0.32%	0.76%	1.06%	1.51%	1.60%	1.91%
Në nivel kombëtar	19.21%	18.36%	17.15%	16.96%	15.23%	13.09%



Grafiku 3-4: Shpërndarja e notave vjetore

Në nivel kombëtar, në provimin e arsimit bazë për lëndën e Gjuhës Shqipe:

- kalueshmëria është **99.76 %**.
- nota me përqindjen më të lartë është **nota 8** me **27.43%**.
- përqindja e nxënësve të vlerësuar me notën 10 është e lartë (8.01%).


3.3 Qëndrueshmëria e arritjeve sipas urbanizimit qytet/fshat

Në tabelën 3-5, jepen përqindjet për notat e provimit PKAB dhe ato vjetore sipas kategorisë qytet dhe fshat.

- Të dhënat tregojnë se përqindja e nxënësve që kanë marrë notën 10 në provimin e arsimit bazë, është **8.01%** e totalit të nxënësve, prej të cilëve **1.74%** janë nxënës që i përkasin kategorisë së fshatit, dhe **6.27%** janë nxënës që i përkasin kategorisë së qytetit.
- Rezultatet e arritura në provimin e arsimit bazë, si dhe ato vjetore të nxënësve të qytetit janë përgjithësisht më të larta kundrejt nxënësve të fshatit.
- Në notat e provimit të arsimit bazë nxënësit e qytetit e kanë përqindjen më të lartë në notën 8, ndërsa nxënësit e fshatit në notën 7.
- Në notat vjetore nxënësit e qytetit e kanë përqindjen më të lartë në notën 8, dhe 10, ndërsa nxënësit e fshatit, në notën 5 dhe 6.

Tabela 3-5: Arritjet në PKAB sipas urbanizimit


Urbanizimi	Nota e PKAB në Gjuhë shqipe						
	4	5	6	7	8	9	10
Qytet	0.06%	1.72%	5.29%	10.95%	15.38%	14.15%	6.27%
Fshat	0.18%	4.22%	8.88%	13.00%	12.05%	6.11%	1.74%
Në nivel kombëtar	0.24%	5.94%	14.17%	23.95%	27.43%	20.26%	8.01%



Grafiku 3-5: Arritjet në PKAB sipas urbanizimit

Tabela 3-6: Arritjet vjetore sipas urbanizimit

Urbanizimi	Nota vjetore në Gjuhë shqipe					
	5	6	7	8	9	10
Qytet	8.11%	8.21%	8.69%	9.42%	8.84%	9.07%
Fshat	10.33%	9.42%	7.78%	6.87%	5.78%	3.50%
Në nivel kombëtar	19.21%	18.36%	17.15%	16.96%	15.23%	13.09%



Grafiku 3-6: Arritjet vjetore sipas urbanizimit

3.4 Arritjet sipas gjinisë femra/meshkuj


Nga të dhënat e paraqitura më poshtë, në formë tabelare dhe grafike, për arritjet në provimin kombëtar dhe për arritjet gjatë vitit shkollor mund të veçojmë:

Për provimin e arsimit bazë:

- Vajzat kanë rezultate më të larta se djemtë, si gjatë vitit shkollor, po ashtu edhe në provimin e arsimit bazë.
- Vajzat kanë përqindjen më të lartë në notën 8 me 15.36%, në provimin e arsimit bazë, ndërsa djemtë kanë notën 7 me 14.69%.
- Vajzat kanë përqindjen më të lartë në notat 7,8,9, ndërsa djemtë në notat 6,7,8.

Tabela 3-7: Arritjet PKAB sipas gjinisë

Gjinia	Nota e PKAB në Gjuhë shqipe						
	4	5	6	7	8	9	10
Femra	0.04%	1.32%	3.57%	9.26%	15.36%	13.72%	5.54%
Meshkuj	0.20%	4.62%	10.60%	14.69%	12.06%	6.54%	2.47%
Në nivel kombëtar	0.24%	5.94%	14.17%	23.95%	27.43%	20.26%	8.01%




Grafiku 3-7: Arritjet PKAB sipas gjinisë

Për arritjet gjatë vitit shkollor (nota vjetore):

- Vajzat kanë përqindjen më të lartë në notën 9 me 10.06%, ndërsa djemtë kanë përqindjen më të lartë në notën 5 me 14.87%.
- Për notën 10 vajzat kanë përqindje më të lartë se djemtë (përkatësisht 9.17% vajzat dhe 3.40% djemtë), por përqindja e vajzave që e kanë ruajtur këtë notë, është më e ulët krahasuar me djemtë.

Tabela 3-8: Arritjet vjetore sipas gjinisë

Gjinia	Nota vjetore në Gjuhë shqipe					
	5	6	7	8	9	10
Femra	3.57%	6.09%	8.25%	9.70%	10.06%	9.17%
Meshkuj	14.87%	11.54%	8.22%	6.59%	4.56%	3.40%
Në nivel kombëtar	19.20%	18.36%	17.15%	16.96%	15.23%	13.09%



Grafiku 3-8: Arritjet vjetore sipas gjinisë


Tabela 3-9 jep informacion mbi nivelin e paqëndrueshmërisë së rezultateve vjetore, të krahasuara me rezultatet e fituara në provimin e arsimit bazë për lëndën e gjuhës shqipe.

Tabela 3-93-10: Vlerësimi i qëndrueshmërisë së notës

Notat vjetore në %		Notat PKAB në %						
		4	5	6	7	8	9	10
5	19.21%	0.18%	4.87%	6.55%	6.20%	1.20%	0.20%	0.01%
6	18.36%	0.03%	0.89%	5.82%	6.55%	4.35%	0.66%	0.06%
7	17.15%	0.03%	0.10%	1.20%	7.19%	6.23%	2.23%	0.16%
8	16.96%	0.00%	0.06%	0.41%	2.61%	8.71%	4.41%	0.77%
9	15.23%	0.00%	0.01%	0.09%	1.07%	5.23%	7.09%	1.75%
10	13.09%	0.00%	0.01%	0.11%	0.33%	1.72%	5.67%	5.25%
Gjithsej	100.00%	0.24%	5.94%	14.17%	23.95%	27.43%	20.26%	8.01%

4 Faktorë që kanë ndikuar në rezultatet e provimit të Gjuhës shqipe

Grafiku 4-1, paraqet shpërndarjen e pikëve të fituara nga nxënësit në provimin e arsimit bazë në lëndën e Gjuhës shqipe, për vitin 2018. Grafiku tregon se kemi një shpërndarje normale të arritjeve të nxënësve në provimin e arsimit bazë.



Grafiku 4-1: Shpërndarja e pikëve për provimin e arsimit bazë, Gjuhë shqipe

Nisur nga rezultatet e marra në testin e Gjuhës shqipe, konstatohet se nxënësi shfaq kompetenca në të tri nivelet:

➤ **Shumë mirë**

- dallon temën e teksteve jo letrare dhe letrare;
- zbulon idetë dhe informacionet e teksteve të llojit letrar dhe jo letrar;
- dallon informacionet më të rëndësishme nga më pak të rëndësishme në tekst;
- dallon strukturën e organizimit të teksteve jo letrare në paragrafë;
- dallon tiparet kryesore të gjuhës së teksteve jo letrare;
- shpjegon raportet mes subjektit, mjedisit, kohës dhe personazheve të tekstit jo letrar dhe letrar;
- zbulon figurat më kryesore stilistike të teksteve letrare.
- dallon dhe analizon llojet e fjalive sipas kumtimit, intonacionit, ndërtimit;
- dallon dhe analizon llojet e gjymtyrëve kryesore e të dyta në fjali;
- dallon klasat e fjalëve të ndryshueshme dhe të pandryshueshme;
- përdor drejt në punët me shkrim leksikun më bazik të gjuhës shqipe.

➤ **Mjaftueshëm**

- dallon raportet shkak-pasojë, apo ato argumentuese në tekstet jo letrare;
- analizon dhe vlerëson llojin dhe strukturën e teksteve jo letrare;

- shpjegon qëndrimin e autorit në tekstet jo letrare në raport me referentin;
- analizon zhvillimin e subjektit dhe raportet mes personazheve në tekstin letrar;
- analizon figurat më kryesore stilistike të tekstit letrar;
- gjykon drejt mbi tiparet kryesore të gjuhës së teksteve letrare dhe jo letrare;
- interpreton tekstin, duke përdorur idetë e dhëna në mënyrë të drejtpërdrejtë, si dhe ato të nënkuptuara në tekst;
- dallon fjalitë e thjeshta dhe të përbëra me bashkërenditje dhe me nënrenditje;
- analizon kuptimet e fjalëve, sinonimet dhe shprehjet e figurshme;
- përdor drejt shenjat e pikësimit (pikën, pikëpyetjen).

➤ **Dobët:**

- interpreton e vlerëson tiparet e gjuhës së figurshme të tekstit letrar;
- vlerëson stilin e autorëve në tekstet e llojit letrar dhe jo letrar;
- analizon funksionet e terminologjisë së fushës në tekste të ndryshme jo letrare;
- analizon fjalën sipas ndërtimit dhe fjalëformimit;
- analizon trajtat e shkurtra dhe format e pashtjelluara të foljes;
- organizon drejt strukturën e esesë, duke planifikuar saktë paragrafët hyrës, zhvillues e mbyllës;
- përdor drejt shenjat e pikësimit, apostrofin, presjen e pikëpresjen në punët me shkrim;
- përdor drejt zanoret: e, ë, i/y, u/y në trup të fjalës;
- përdor drejt ë-në fundore;
- përdor gjuhën standarde, leksik të pasur dhe stil vetjak në punën me shkrim.

Në rezultatet e arritjeve të nxënësve në provimin e arsimit bazë për lëndën Gjuhë shqipe, kanë ndikuar një numër faktorësh, ndër të cilët mund të përmendim:

- ekzistenca e niveleve të ndryshme social-ekonomike të familjeve dhe komuniteteve të nxënësve, përkatësisht në qytet dhe fshat, në zona të zhvilluara ose jo.
- prezenca e niveleve të ndryshme të cilësisë në mësimdhënie, gjatë procesit mësimor, në qytet dhe fshat, si edhe në sistemin publik dhe atë privat;
- cilësia e teksteve të nxënësit në arsimin bazë, që shpesh e dëmton procesin e mësimdhënies;
- shkalla e ulët e motivimit të nxënësve nga ana e mësuesve, për të nxitur punën e pavarur të tyre në përmbushjen e kërkesave të programit;
- mësimdhënia e bazuar vetëm në tekstet bazë për nxënësit, duke i orientuar nxënësit drejt të mësuarit mekanik dhe duke kufizuar kështu zhvillimin e aftësive analitike e krijuese të nxënësve;

- neglizhenca e mësuesve në ushtrimin e nxënësve në vijimësi në punët me shkrim, të orientuara dhe nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të mësuesve, ose edhe angazhimi i tyre në punë të pavarura me shkrim;
- prania e fiktivitetit në vlerësimin e nxënësve gjatë procesit mësimor;
- administrimi jo korrekt i mjediseve ku është zhvilluar provimi i arsimit bazë.

5 Lënda: Matematikë

5.1 Arritjet e Nxënësve

Në provimin e arsimit bazë, lënda Matematikë morën pjesë 37406 nxënës dhe munguan 928 prej tyre.

Në tabelën 5-1, paraqiten arritjet mesatare të nxënësve në lëndën e Matematikës në **nivel kombëtar**, sipas **urbanizimit fshat/qytet** (referuar vendndodhjes së shkollës), sipas **gjinisë femra/meshkuj** dhe sipas **sistemit publik/privat** të edukimit.

Tabela 5-1: Arritjet mesatare të nxënësve sipas kategorive

Urbanizimi	Gjinia	Pikët e fituara në test		Nota e PKAB-së		Nota Vjetore	
		Mesatarja e pikëve	<i>Shmangia</i> <i>mesatare</i>	Nota mesatare	<i>Shmangia</i> <i>mesatare</i>	Nota mesatare	<i>Shmangia</i> <i>mesatare</i>
Në nivel kombëtar	Femra	29.33	11.06	7.46	1.54	7.24	1.70
	Meshkuj	24.70	10.24	6.81	1.45	6.37	1.60
	Total	26.95	10.90	7.13	1.53	6.79	1.70
Qytet	Femra	31.97	11.11	7.82	1.54	7.47	1.74
	Meshkuj	27.26	10.82	7.17	1.52	6.60	1.71
	Total	29.56	11.21	7.49	1.57	7.03	1.78
Fshat	Femra	26.27	10.19	7.04	1.43	6.97	1.60
	Meshkuj	21.80	8.68	6.41	1.26	6.10	1.42
	Total	23.95	9.70	6.71	1.38	6.52	1.57
Publik (në nivel kombëtar)	Femra	28.74	10.91	7.38	1.52	7.17	1.69
	Meshkuj	24.12	9.94	6.74	1.41	6.30	1.56
	Total	26.36	10.68	7.05	1.50	6.72	1.68
Qytet	Femra	31.20	11.07	7.72	1.54	7.37	1.74
	Meshkuj	26.55	10.61	7.07	1.49	6.49	1.67
	Total	28.81	11.08	7.38	1.55	6.91	1.76
Fshat	Femra	26.22	10.16	7.03	1.43	6.96	1.60
	Meshkuj	21.69	8.57	6.40	1.24	6.10	1.42
	Total	23.88	9.64	6.70	1.37	6.52	1.57
Privat (në nivel kombëtar)	Femra	37.13	10.01	8.52	1.39	8.24	1.57
	Meshkuj	32.54	11.00	7.88	1.53	7.48	1.70
	Total	34.80	10.77	8.19	1.49	7.86	1.68
Qytet	Femra	37.24	9.91	8.53	1.37	8.26	1.56
	Meshkuj	32.46	10.95	7.87	1.52	7.50	1.69

	Total	34.84	10.71	8.20	1.49	7.88	1.67
	Femra	34.35	12.13	8.10	1.68	7.73	1.78
Fshat	Meshkuj	33.75	11.80	8.01	1.62	7.12	1.78
	Total	33.98	11.88	8.05	1.63	7.35	1.80

Në nivel kombëtar:

- **mesatarja e pikëve** të fituara në provimin e arsimit bazë në lëndën e Matematikës është **26.95 pikë**, me shmangie mesatare **10.90**;
- **nota mesatare e arsimit bazë** është 7.13, me shmangie mesatare 1.53;
- **nota mesatare vjetore** është 6.79 me shmangie mesatare 1.70.

Në nivel kombëtar, nga krahasimi i vlerave të notës mesatare në provimin e arsimit bazë, me notën mesatare vjetore, rezulton se ndryshueshmëria është me 0.34 njësi note.

Rezultatet e nxënësve në provimin e arsimit bazë janë më të larta, krahasuar me arritjet vjetore të nxënësve. Kjo gjetje qëndron për të gjitha kategoritë që janë paraqitur në tabelën 5-1.

5.2 Arritjet sipas urbanizimit qytet/fshat

- Nëse analizojmë arritjet e nxënësve në nivel kombëtar, sipas elementëve të urbanizimit qytet/fshat të paraqitura në Tabelën 5-1, rezulton se mesatarja e pikëve të nxënësve të qytetit është më e lartë ndaj nxënësve të fshatit dhe konkretisht për çdo kategori kemi:
- Në nivel kombëtar, arritjet e nxënësve sipas kategorive të urbanizimit fshat/qytet, tregojnë se kemi diferenca të dukshme mes arritjeve të nxënësve që kanë ndjekur shkollën në qytet kundrejt atyre që e kanë ndjekur shkollën në fshat. Mesatarja e pikëve të nxënësve të qytetit rezulton të jetë **5.61 pikë** më e lartë ndaj nxënësve të fshatit.
- Për sistemin publik, mesatarja e pikëve të nxënësve të qytetit është **4.93 pikë** më e lartë ndaj nxënësve të fshatit
- Për sistemin privat, mesatarja e pikëve të nxënësve të qytetit është **0.87 pikë** më e lartë ndaj nxënësve të fshatit

5.3 Arritjet sipas gjinisë:

Të dhënat e tabelës 5-1 tregojnë se:

- në provimin e arsimit bazë, arritjet mesatare të vajzave janë më të larta krahasuar me arritjet mesatare të djemve.

- arritjet mesatare të vajzave janë 2.38 pikë mbi mesataren e pikëve në nivel kombëtar.
- mesatarja e pikëve të fituara nga vajzat, në nivel kombëtar, është 29.33 pikë, ose 4.63 pikë më e lartë, se mesatarja e pikëve të fituara nga djemtë.
- arritjet e vajzave në provimin e arsimit bazë janë 0.22 njësi note më të larta kundrejt arritjeve vjetore (në nivel kombëtar: 7.46 nota mesatare e PKAB; 7.24 nota mesatare vjetore).
- për djemtë, arritjet në provimin e PKAB janë 0.45 njësi note më e lartë kundrejt rezultateve vjetore të tyre (në nivel kombëtar: 6.81 nota mesatare PKAB; 6.37 nota mesatare vjetore).

5.4 Arritjet sipas sistemit publik/privat të edukimit:

Nga analiza e të dhënave rezulton se:

- arritjet mesatare të nxënësve në sistemin privat të edukimit janë më të larta se arritjet e nxënësve të sistemit publik, kjo si për mesataren e pikëve të fituara në provim, po ashtu edhe për notën mesatare PKAB dhe atë vjetore.
- Sistemi privat me atë publik në nivel kombëtar ka një diferencë prej **8.44 pikësh** të mesatares së pikëve. Kjo tregon se në lëndën e matematikës, ka diferenca të mëdha mes arritjeve në dy sistemet arsimore që ekzistojnë në vendin tonë.
- Në sistemin privat ashtu si dhe në atë publik, arritjet e nxënësve në provimin e arsimit bazë janë më të larta krahasuar me arritjet vjetore të tyre. Për sistemin privat kjo diferencë është **0.34 njësi note**, ndërsa për atë publik **0.33 njësi note**.

5.5 Qëndrueshmëria e arritjeve


Nëse do të analizojmë qëndrueshmërinë e arritjeve të nxënësve në provimin e arsimit bazë kundrejt arritjeve vjetore, për lëndën e matematikës shihet se:

- për sistemin publik, arritjet e nxënësve të fshatit janë më të qëndrueshme krahasuar me arritjet e nxënësve të qytetit, ndërsa për sistemin privat ndodh e kundërta.

Tabela 5-2 jep shpërndarjen (në përqindje) të notave të PKAB dhe notave vjetore për lëndën e Matematikës.

Tabela 5-2: Shpërndarja e notave për lëndën e Matematikës

Sistemi i edukimit	Nota e PKAB në Matematikë						
	4	5	6	7	8	9	10
Publik	0.42%	14.63%	23.38%	22.02%	14.70%	10.18%	7.70%
Jopublik	0.00%	0.40%	0.64%	1.21%	1.40%	1.61%	1.71%
Në nivel kombëtar	0.43%	15.03%	24.02%	23.23%	16.10%	11.79%	9.41%




Grafiku 5-1: Shpërndarja e notave PKAB, për lëndën e Matematikës

Në provimin e arsimit bazë, në nivel kombëtar:

- kalueshmëria është **99.57%**.
- Nota mbizotëruese është **Nota 6 me 24.02%**.
- Përqendrimi më i madh është në notat 6, 7 dhe 8 të cilat së bashku përbëjnë 63.35%.
- Përqindja e nxënësve të vlerësuar me Notën 10 shkon në 9.41 %.

Tabela 5-3: Shpërndarja e notave vjetore për lëndën e Matematikës

Sistemi i edukimit	Nota e vjetore në Matematikë					
	5	6	7	8	9	10
Publik	32.04%	18.35%	13.21%	11.50%	9.88%	8.05%
Jopublik	0.78%	1.02%	1.03%	1.21%	1.35%	1.58%
Në nivel kombëtar	32.83%	19.37%	14.24%	12.71%	11.23%	9.62%




Grafiku 5-2: Shpërndarja e notave vjetore të Matematikës

Për notat vjetore, në nivel kombëtar:

- Nota mbizotëruese është **Nota 5 me 32.83%**.
- Përqendrimi më i madh është në notat 5,6 dhe 7 të cilat së bashku përbëjnë 66.43%.
- Përqindja e nxënësve të vlerësuar me Notën 10 shkon në 9.62 %.
- Notat 9 dhe 10 kanë ruajtur qëndrueshmërinë e tyre.

Grafiku 5-3, jep një paraqitje krahasuese midis arritjeve në provimin e arsimit bazë dhe ato vjetore.



Grafiku 5-3: Arritjet në provimin e matematikës

5.6 Arritjet sipas urbanizimit qytet/fshat

Tabela 5-4 paraqet arritjet në provimin e arsimit bazë, lënda matematikë, sipas urbanizimit.

Tabela 5-4: Shpërndarja e notave të Matematikës sipas urbanizimit

Urbanizimi	Nota e PKAB në Matematikë						
	4	5	6	7	8	9	10
Qytet	0.14%	5.77%	10.21%	12.06%	9.73%	8.05%	7.43%
Fshat	0.28%	9.25%	13.81%	11.17%	6.37%	3.74%	1.99%
Në nivel kombëtar	0.43%	15.03%	24.02%	23.23%	16.10%	11.79%	9.41%

Nga të dhënat e tabelës 5-4 vërejmë se:

- Përqindja e nxënësve që kanë marrë notën 10 në provimin e arsimit bazë është 9.41% e numrit të përgjithshëm të nxënësve, prej të cilëve, vetëm 1.99% janë nxënës që i përkasin kategorisë fshat, ndërsa pjesa tjetër prej 7.43% i përkasin kategorisë qytet.
- Shihet se, për kategorinë qytet nota me përqindjen më të lartë është nota 7 me 12.06%, ndërsa për kategorinë fshat është nota 6, me përkatesisht 13.81% të nxënësve.

Tabela 5-5: Shpërndarja e notave vjetore të Matematikës, sipas urbanizimit

Urbanizimi	Nota e vjetore në Matematikë					
	5	6	7	8	9	10
Qytet	15.50%	9.48%	7.42%	7.14%	6.79%	7.07%
Fshat	17.33%	9.89%	2.56%	6.82%	5.57%	4.44%
Në nivel kombëtar	32.83%	19.37%	14.24%	12.71%	11.23%	9.62%

Për notat vjetore, sipas urbanizimit qytet/fshat vërejmë se 9.62% e nxënësve ka marrë notën 10, shifër kjo e krahasueshme me përqindjen përkatese, 9.41%, të kësaj note në rezultatet e provimit të arsimit bazë, për këtë lëndë.

Gjithashtu vihet re se 7.07% e nxënësve të qytetit kanë marrë notën 10, përqindje kjo pothuaj e njëjtë, me atë të notës 10, në rezultatet e provimit të arsimit bazë, për këtë lëndë, për të njëjtën kategori.

Nxënësit e fshatit që janë vlerësuar me notën 10 në shkollë për lëndën matematikë, janë 4.44%, ndërkohë që ata që janë vlerësuar me notën 10 në provimin e PKAB për këtë lëndë, janë 1.99%.

5.7 Arritjet sipas gjinisë femra/meshkuj

Tabela 5-6 paraqet arritjet në provimin e arsimit bazë, lënda matematikë, sipas gjinisë.

Tabela 5-6: Shpërndarja e notave të Matematikës sipas gjinisë

Gjinia	Nota e PKAB në Matematikë						
	4	5	6	7	8	9	10
Femra	0.15%	5.26%	9.29%	11.08%	9.19%	7.42%	6.13%
Meshkuj	0.28%	9.77%	14.72%	12.15%	6.91%	4.37%	3.28%
Në nivel kombëtar	0.43%	15.03%	24.02%	23.23%	16.10%	11.79%	9.41%

- vajzat kanë rezultate më të larta se djemtë, si gjatë vitit shkollor, po ashtu edhe në provimin e arsimit bazë.
- tabela 5-6 tregon se, përqindja e nxënësve që kanë marrë notën 10 në provimin e arsimit bazë është 9.41% e totalit të nxënësve, prej të cilëve 6.13% janë vajza dhe 3.28% janë djem.

Tabela 5-7: Shpërndarja e notave vjetore të Matematikës sipas gjinisë


Gjinia	Nota e vjetore në Matematikë					
	5	6	7	8	9	10
Femra	9.88%	9.71%	6.36%	7.85%	7.52%	7.20%
Meshkuj	22.95%	9.66%	3.26%	6.38%	5.19%	4.03%
Në nivel kombëtar	32.83%	19.37%	14.24%	12.71%	11.23%	9.62%

Për lëndën e matematikës, rezulton se:


- Numri i nxënësve të vlerësuar me notën 10 në provimin e arsimit bazë (9.41%) është afërsisht e njëjtë me përqindjen e nxënësve të vlerësuar po me notën 10 gjatë procesit mësimor (9.62%).
- Përqindja e mbetësve në provimin e arsimit bazë për kategorinë “meshkuj” është afërsisht 2 herë më e madhe krahasuar me kategorinë “femra”.
- Në rezultatet e provimit të arsimit bazë, për vajzat nota me përqindjen më të lartë, është nota 7 me 11.08%, ndërsa për djemtë është nota 6 me 14.72%. Në rezultatet vjetore, vihet re se nota 5, ka përqindjen më të madhe, si për vajzat ashtu dhe për djemtë.
- Për kategorinë qytet nga 15.50% që kanë marrë notën 5 në vlerësimin vjetor, vetëm 5.77% e tyre kanë marrë po këtë notë në provimin e arsimit bazë.
- Për kategorinë fshat, nga 17.33% që janë vlerësuar me notën 5, në vlerësimin vjetor, vetëm 9.25% e tyre, kanë marrë po këtë notë në provimin e arsimit bazë.
- Për kategorinë qytet notën 7 në vlerësimin vjetor e kanë marrë 7.42% e nxënësve, ndërsa në provimin e arsimit bazë me këtë notë janë vlerësuar 12.06% e tyre.
- Për kategorinë fshat notën 7 në vlerësimin vjetor e kanë marrë 2.56% e nxënësve, ndërsa në provimin e arsimit bazë me këtë notë janë vlerësuar 11.17% e tyre.
- Për kategorinë fshat, kemi rënie prej 2.45 % të numrit të nxënësve të vlerësuar me notën 10 në provimin e arsimit bazë (1.99%), kundrejt vlerësimit vjetor (4.44%). Për kategorinë qytet, kjo diferencë është shumë e vogël.
- Përqindja e nxënësve të vlerësuar me notën 10 gjatë procesit mësimor vjetor është 9.62%, prej të cilëve 7.20% janë vajza, dhe 4.03% djem. Përqindja e nxënësve të vlerësuar me

notën 10 në provimin e arsimit bazë është 9.41%, prej të cilëve 6.13% janë vajza dhe 3.28% janë djem.

Më poshtë paraqiten grafikisht të dhënat e tabelave 5-6 dhe 5-7.




Grafiku 5-5: Arritjet në provimin e arsimit bazë, lënda matematikë, sipas gjinisë



Grafiku 5-4: Arritjet vjetore në matematikë, sipas gjinisë

6 Faktorë që kanë ndikuar në rezultatet e provimit të Matematikës

Grafiku 6-1 paraqet shpërndarjen e pikëve të fituara nga nxënësit në provimin e arsimit bazë 2018, në lëndën e matematikës. Grafiku paraqet një shpërndarje relativisht jo-normale, të zhvendosur ndaj boshtit vertikal.



Grafiku 6-1: Shpërndarja e pikëve për matematikën

Shihet se përqendrimi më i madh (62.27%) është në intervalin 13-27 pikë, që i përket notave 5-7, më tej grafiku pëson një rënie dhe në vijim vazhdon pothuaj njëtrajtësisht.

Tabela 6-1, jep arritjet mesatare për çdo DAR/ZA.

Tabela 6-1: Arritjet mesatare për çdo DAR/ZA

Nr	DAR/ZA	Pikë mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare e provimit	Shmangia mesatare	Nota mesatare vjetore	Shmangia mesatare
Në nivel kombëtar		26.95	11.06	7.46	1.54	7.24	1.7
1	BERAT	25.33	10.91	6.90	1.53	6.95	1.80
2	BULQIZË	25.91	10.62	6.99	1.48	6.86	1.76
3	DELVINË	30.48	9.81	7.57	1.40	7.21	1.56
4	DEVOLL	30.55	10.90	7.64	1.51	6.83	1.79
5	DIBËR	23.12	9.12	6.60	1.30	6.47	1.61
6	DURRËS	25.34	11.07	6.91	1.57	6.55	1.68
7	ELBASAN	26.25	10.63	7.02	1.49	6.63	1.63
8	FIER	23.18	9.13	6.60	1.33	6.46	1.59
9	GJIROKASTËR	24.63	11.03	6.77	1.55	7.07	1.81

10	GRAMSH	29.72	10.51	7.54	1.46	6.98	1.68
11	HAS	32.10	10.24	7.81	1.43	6.98	1.78
12	KAMËZ	20.85	8.44	6.24	1.23	6.26	1.48
13	KAVAJË	30.42	10.34	7.61	1.41	6.69	1.70
14	KOLONJË	28.10	11.72	7.28	1.63	7.17	1.80
15	KORÇË	27.99	10.82	7.28	1.53	6.84	1.77
16	KRUJË	28.03	9.91	7.29	1.38	6.91	1.70
17	KUÇOVË	20.17	9.44	6.21	1.33	6.22	1.53
18	KUKËS	24.73	9.96	6.84	1.44	6.99	1.69
19	KURBIN	32.00	9.98	7.83	1.37	6.84	1.63
20	LEZHË	24.28	10.24	6.75	1.46	6.44	1.58
21	LIBRAZHD	22.40	8.35	6.50	1.21	6.49	1.21
22	LUSHNJE	31.80	11.09	7.80	1.49	6.84	1.78
23	MALËSI E MADHE	24.43	9.76	6.78	1.38	6.31	1.52
24	MALLAKASTËR	29.23	10.11	7.46	1.40	6.81	1.72
25	MAT	21.09	9.63	6.30	1.36	6.45	1.64
26	MIRDITË	25.34	9.41	6.95	1.34	6.65	1.67
27	PEQIN	27.70	12.27	7.19	1.73	6.71	1.78
28	PËRMET	17.71	9.76	5.86	1.36	6.45	1.47
29	POGRADEC	31.28	11.72	7.69	1.67	7.27	1.80
30	PUKË	27.49	10.31	7.25	1.45	6.89	1.54
31	SARANDË	28.23	10.13	7.31	1.43	7.02	1.74
32	SHKODËR	26.32	10.14	7.07	1.42	6.46	1.66
33	SKRAPAR	23.53	8.24	6.67	1.18	6.53	1.46
34	TEPELENË	20.14	9.30	6.21	1.35	6.91	1.79
35	TIRANË	30.77	10.96	7.64	1.53	7.11	1.80
36	TIRANË QARK	22.24	8.99	6.49	1.30	6.50	1.58
37	TROPOJË	33.21	10.59	8.04	1.55	7.25	1.76
38	VLOBË	32.23	9.75	7.86	1.34	7.87	1.33

Nisur nga rezultatet e marra në testin e matematikës, nxënësit shfaqin kompetenca në nivelin:

Shumë mirë:

- përdor shumë mirë vetitë e fuqive;
- zgjidh ekuacione të fuqisë së parë me një ndryshore;
- zbaton formulën për gjetjen e mesatares aritmetike;
- gjen prerjen dhe bashkimin e bashkësive numerike;
- përdor kuptimin e numrit racional, irracional dhe real;
- kryen veprime me rrënjë me tregues n .

Mjaftueshëm:

- gjen bashkësinë e përcaktimit të një funksioni të dhënë;
- zgjidh inekuacione të fuqisë së parë me një ndryshore;
- njeh dhe zbaton formulat e Vietës;
- zgjidh sisteme ekuacionesh të fuqisë së parë me dy ndryshore, (me tre metodat e zgjidhjes);
- shndërron shprehjet algebrike me shprehje identike me to;
- zbaton formulat dhe vetitë e funksioneve trigonometrike.

Dobët:

- interpreton përkufizimin klasik të probabilitetit të një ngjarjeje;
- gjen sipërfaqen e figurave plane (drejtkëndësh, paralelogram dhe trekëndësh);
- gjen sipërfaqen e sferës;
- zbaton marrëdhëniet në trekëndëshin kënddrejtë (Teorema e Euklidit dhe e Pitagorës),
- zbaton vetitë e këndeve rrethorë;
- kryen veprime me vektorë (mbledhje, zbritje).

Ndër faktorët që kanë ndikuar në rezultatet e nxënësve në provimin e arsimit bazë për lëndën e Matematikës renditim:

- ekzistenca e niveleve të ndryshme cilësie në mësimdhënie gjatë procesit mësimor, kjo më e dallueshme mes qytetit dhe fshatit, si dhe mes sistemit publik dhe atij privat;
- nivele të ndryshme të cilësisë dhe kualifikimit të mësuesve në nivel kombëtar, por edhe mes sistemit privat dhe atij publik, qytetit dhe fshatit;
- shkalla e faktorëve motivues të mësuesve gjatë procesit mësimor;
- niveli social-ekonomik i familjeve dhe komuniteteve përkatëse të nxënësve;
- fiktiviteti në vlerësimin e nxënësve gjatë procesit mësimor.

7 Lënda: Gjuhë e Huaj

7.1 Arritjet e Nxënësve

Në provimin e arsimit bazë gjuhë e huaj nxënësit kanë dhënë provim njëhën nga gjuhët e huaja: Anglisht, Frëngjisht, Italisht ose Gjermanisht, bazuar në kurrikulën shkollore si dhe rregulloren e zhvillimit të provimeve kombëtare të arsimit bazë.

Në tabelën 7-1, jepen arritjet mesatare të nxënësve në provimin e arsimit bazë, gjuhë e huaj. Grafiku 7-1, jep informacion mbi arritjet mesatare të nxënësve në lëndën e gjuhës së huaj në nivel kombëtar.


Tabela 6-2: Arritjet mesatare për çdo DAR/ZA në gjuhë të huaj

	DAR/ZA	Pikë mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare e provimit	Shmangia mesatare	Nota mesatare vjetore	Shmangia mesatare
Nr	Në nivel kombëtar	34.79	10.32	8.20	1.41	7.30	1.82
1	BERAT	33.78	10.31	8.07	1.41	8.09	1.46
2	BULQIZË	27.31	10.15	7.19	1.42	6.45	1.64
3	DELVINË	37.76	8.95	8.58	1.21	7.51	1.74
4	DEVOLL	36.28	9.83	8.43	1.32	7.12	1.90
5	DIBËR	33.56	9.35	8.03	1.30		
6	DURRËS	33.86	10.88	8.08	1.46	7.09	1.82
7	ELBASAN	32.18	10.92	7.84	1.51	6.99	1.76
8	FIER	33.83	10.03	8.06	1.38	7.73	1.70
9	GJIROKASTËR	34.46	11.30	8.15	1.57	7.64	1.90
10	GRAMSH	35.91	8.91	8.35	1.24	7.90	1.45
11	HAS	38.58	7.98	8.70	1.13	7.33	1.83
12	KAMËZ	34.35	9.95	8.11	1.37	6.91	1.73
13	KAVAJË	32.95	10.68	7.96	1.45	6.98	1.83
14	KOLONJË	35.07	11.86	8.24	1.64	7.80	1.69
15	KORÇË	34.19	10.79	8.12	1.47	7.01	1.83
16	KRUJË	34.75	9.14	8.19	1.24	7.05	1.75
17	KUÇOVË	26.73	10.69	7.10	1.48	6.78	1.74
18	KUKËS	33.10	8.81	7.98	1.25	7.04	1.74
19	KURBIN	34.09	7.98	8.11	1.12	7.24	1.79
20	LEZHË	34.76	9.43	8.21	1.28	6.98	1.76
21	LIBRAZHD	35.36	9.89	8.28	1.35		
22	LUSHNJE	35.02	9.11	8.22	1.23	7.16	1.83
23	MALËSI E MADHE	32.94	9.54	7.89	1.32	6.98	1.81

24	MALLAKASTËR	35.10	8.56	8.25	1.19	7.16	1.82
25	MAT	28.93	9.67	7.41	1.34	6.95	1.74
26	MIRDITË	31.77	10.54	7.81	1.45	7.08	1.73
27	PEQIN	28.40	12.42	7.25	1.79	6.87	1.82
28	PËRMET	27.33	9.62	7.19	1.37	6.61	1.60
29	POGRADEÇ	33.94	11.07	8.05	1.54	7.36	1.78
30	PUKË	33.22	9.50	8.00	1.30	7.01	1.66
31	SARANDË	37.06	10.04	8.49	1.40	7.27	1.82
32	SHKODËR	36.02	9.76	8.37	1.34	7.05	1.82
33	SKRAPAR	29.24	9.73	7.47	1.34	6.45	1.42
34	TEPELENË	33.62	9.97	8.06	1.37	7.27	1.75
35	TIRANË	39.79	9.34	8.86	1.26	7.96	1.81
36	TIRANË QARK	32.13	9.50	7.86	1.32	6.90	1.67
37	TROPOJË	37.74	7.98	8.62	1.13	7.48	1.76
38	VLORË	35.85	10.25	8.34	1.41	7.49	1.81

		Pikët e fituara në test		Nota e PKAB-së		Nota Vjetore	
Urbanizimi	Gjinia	Mesatarja	Shmangia	Nota	Shmangia	Nota	Shmangia
		e pikëve	mesatare	mesatare	mesatare	mesatare	mesatare
Në nivel kombëtar	Femra	37.35	9.75	8.54	1.34	7.88	1.71
	Meshkuj	32.33	10.26	7.86	1.41	6.74	1.74
	Total	34.79	10.32	8.20	1.41	7.30	1.82
Qytet	Femra	40.37	8.99	8.95	1.23	8.22	1.70
	Meshkuj	35.63	10.03	8.31	1.37	7.11	1.84
	Total	37.95	9.82	8.62	1.34	7.65	1.86
Fshat	Femra	33.97	9.45	8.08	1.30	7.49	1.64
	Meshkuj	28.60	9.18	7.37	1.27	6.31	1.49
	Total	31.23	9.69	7.72	1.34	6.89	1.67
Publik (në nivel kombëtar)	Femra	36.80	9.75	8.47	1.34	7.80	1.71
	Meshkuj	31.63	10.08	7.77	1.38	6.63	1.69
	Total	34.16	10.25	8.11	1.40	7.20	1.80
Qytet	Femra	39.72	9.16	8.86	1.25	8.11	1.72
	Meshkuj	34.77	10.01	8.19	1.37	6.94	1.81
	Total	37.19	9.92	8.52	1.35	7.51	1.86
Fshat	Femra	33.90	9.44	8.07	1.30	7.48	1.64
	Meshkuj	28.49	9.11	7.35	1.26	6.30	1.48
	Total	31.15	9.66	7.71	1.33	6.88	1.67
Privat (në nivel kombëtar)	Femra	44.95	5.83	9.55	0.80	8.94	1.39
	Meshkuj	41.91	7.61	9.15	1.06	8.28	1.60
	Total	43.40	6.96	9.35	0.96	8.61	1.54
Qytet	Femra	45.02	5.83	9.56	0.80	8.95	1.39
	Meshkuj	41.92	7.67	9.15	1.07	8.31	1.61
	Total	43.45	6.99	9.35	0.97	8.63	1.54
Fshat	Femra	43.52	5.73	9.34	0.77	8.59	1.40
	Meshkuj	41.79	6.61	9.12	0.95	7.95	1.49
	Total	42.51	6.30	9.21	0.88	8.22	1.48

Tabela 6-3: Arritjet mesatare të nxënësve sipas kategorive në gjuhë të huaj



Grafiku 6-2: Arritjet mesatare në gjuhë të huaj

7.2 Në nivel kombëtar

- Mesatarja e pikëve të fituara në provimin e gjuhës së huaj është 34.79 pikë me shmangie mesatare 10.32,
- Nota mesatare e provimit të gjuhës së huaj të arsimit bazë është 8.20, me shmangie mesatare 1.41,
- Nota mesatare vjetore 7.30 me shmangie mesatare prej 1.82.

Nga krahasimi i vlerave të notës mesatare vjetore me notën mesatare të PKAB, referuar po nivelit kombëtar, rezulton se arritjet e nxënësve në provimin PKAB janë më të larta krahasuar me arritjet vjetore, me rreth (0.89) njësi note.

7.3 Arritjet sipas urbanizimit qytet/fshat

Rezultatet e nxënësve në nivel kombëtar sipas elementëve të urbanizimit fshat/qytet, tregojnë se:

- ka diferenca mes arritjeve të nxënësve që kanë ndjekur shkollën në qytet kundrejt atyre të fshatit.
- mesatarja e pikëve të nxënësve të qytetit rezulton të jetë rreth **6.72 pikë** më e lartë ndaj nxënësve të fshatit.
- ekzistenca e diferencës prej 6.72 pikësh në mesataren e pikëve pasqyrohet edhe në diferencën që ekziston me rreth **0.13** njësi note mes dy kategorive.

7.4 Arritjet sipas gjinisë

Disa nga treguesit e Gjuhës së Huaj sipas gjinisë:

- vajzat dallohen për arritje mesatare më të larta krahasuar me arritjet mesatare të djemve, kjo si për sistemin publik, po ashtu edhe për sistemin privat.
- Arritjet e vajzave janë rreth **5.03 pikë** më të larta në nivel kombëtar në krahasim me arritjet e djemve
- Në fshat diferenca midis arritjeve të vajzave dhe djemve shkon deri në 0.72 njësi note.

7.5 Arritjet sipas sistemit publik/privat të edukimit

- Mesatarja e pikëve të fituara në provimin e arsimit bazë për kategorinë qytet, të sistemit privat është 43.45 pikë, e cila përbën dhe vlerën më të lartë të mesatares së pikëve të fituara në testim, duke patur parasysh të gjitha kategoritë e sistemit publik e privat.
- Gjithashtu, vihet re se, nota mesatare vjetore e kategorisë fshat, të sistemit privat, është më e ulët se nota mesatare vjetore e kategorisë qytet të sistemit privat, me rreth 0.41 njësi note.

Nga të dhënat e tabelës 7-2, rezulton se, për të gjitha kategoritë fshat/qytet, femra/meshkuj dhe publik/privat, arritjet mesatare të nxënësve në provimin e arsimit bazë janë më të larta kundrejt arritjeve vjetore të tyre.

Të dhënat e tabelës 7-3 paraqet arritjet e nxënësve në secilën lëndë të gjuhës së huaj (anglisht, frëngjisht, italisht). Nga të dhënat rezulton se:


- Arritjet më të larta në provimin e arsimit bazë i takojnë nxënësve, të cilët mësojnë gjuhë të huaj Anglisht, më pas vjen gjuha Italisht dhe Frëngjisht.
- Mesatarja e pikëve të fituara në testim për gjuhën e huaj Anglisht është 35.66 pikë, Frëngjisht 27.05 pikë, Italisht 33.36 pikë
- Diferenca e madhe që ekziston mes mesatares së pikëve në provimin e arsimit bazë mes gjuhëve Anglisht e Frëngjisht.

Tabela 6-4 Arritjet e nxënësve në secilën lëndë të gjuhës së huaj


Lënda	Pikët e fituara në test		Nota e PKAB-së		Nota Vjetore	
	Mesatarja	<i>Shmangia</i>	Nota	<i>Shmangia</i>	Nota	<i>Shmangia</i>
	e pikëve	<i>mesatare</i>	mesatare	<i>mesatare</i>	mesatare	<i>mesatare</i>
Anglisht	35.66	10.16	8.31	1.39	7.35	1.83
Frëngjisht	27.05	8.79	7.17	1.22	6.79	1.65
Italisht	33.36	9.53	8.02	1.32	7.52	1.82

8 Faktorë që kanë ndikuar në rezultatet e provimit të gjuhës së huaj


Grafikët 8-1 paraqet shpërndarjen e pikëve të fituara nga nxënësit në provimin e arsimit bazë në lëndën e gjuhës së huaj . Grafikët 8-2,8-3,8-4 paraqesin shpërndarjen e pikëve të fituara nga nxënësit në provimin e arsimit bazë për secilën gjuhë.




Grafiku 6-3: Shpërndarja e pikëve për gjuhën e huaj



Grafiku 8-2: Shpërndarja e pikëve për anglishten




Grafiku 8-3: Shpërndarja e pikëve për italishten




Grafiku 8-4: Shpërndarja e pikëve për frëngjishten

Grafiku 8-5 jep një paraqitje të shpërndarjes së notave të provimit të arsimit bazë. Vihet re se notat 7 dhe 8 kane përqindjen më të lartë, përkatësisht me 21% dhe 23%. Në arritjet vjetore, nota me përqindjen më të lartë, është nota 5 (23%) dhe nota 6 (18%), grafiku 8-6.



Grafiku 6-5: Shpërndarja e notave PKAB, gjuhë e huaj



Grafiku 6-6: Shpërndarja e notave vjetore, gjuhë e huaj

Nisur nga rezultatet e marra në testin e gjuhës së huaj nxënësi shfaq kompetenca në nivelin:

Shumë mirë

- zgjidh shumë saktë ushtrimet me format e ndryshme të kohës së ardhme (Use of Language);
- zbaton shumë saktë struktura të thjeshta si *there is/there are* (Use of Language);
- plotësojnë shumë saktë foljet më të rëndësishme modale me formën bazë të foljeve (Use of Language);
- plotëson saktë ushtrimet ku kërkohet përdorimi i kohëve të sakta në një paragraf të caktuar (Use of Language);
- përdor saktë folje frazale të thjeshta në fjali ose ushtrime me situata të jetës së përditshme (Use of Language);
- përzgjedh saktë fjalën në një grup fjalësh të një familjeje (Use of Language);
- plotëson saktë ushtrimet me gjuhë funksionale;
-

Mirë

- gjen shkakun e një ngjarjeje në një tekst (Reading Comprehension);
- gjen detajet specifike në tekst (Reading Comprehension);
- gjen llojin e një teksti (Reading Comprehension);
- gjen informacione të detajuara (Reading Comprehension);
- shkruan një letër informale ose email informal, duke respektuar strukturën e një letre ose email-i jo-formal. (Writing Section).

Dobët:

- shpjegon dhe arsyeton një ngjarje të caktuar në një tekst të dhënë (Reading Comprehension);
- gjen informacione specifike të detajuara në disa tekste paralele në tekste krahasuese. (Reading Comprehension).

Faktorë që kanë ndikuar në rezultatet e provimit të Gjuhës së Huaj

- Të mësuarit e gjuhës së huaj që nga klasa e tretë dhe në disa raste edhe më herët, është një faktor shumë domethënës në performancën e nxënësve në këtë lëndë.
- Ndjekja e kurseve private në gjuhët e huaja, është tjetër faktor i rezultateve të mira në këtë provim.
- Përdorimi masiv i rrjeteve sociale nga kjo grup moshë bëhet edhe në gjuhë të huaj, duke e bërë natyrshëm thithjen e gjuhës dhe duke u bërë faktor në mbarëvajtjen e kësaj grup moshe në këtë lëndë e në performancën e tyre në provim.
- Programi mësimor dhe karakteristikat e testit të cilat mbështeten në Kornizën Europiane të Gjuhëve, duke respektuar rigorozisht nivelin A2, bën që nxënësit të ndihen mirë dhe lirshëm në këtë provim pasi tekstet me të cilat punojnë deri në klasë të 9, i nxjerrin nxënësit me njohuri gjuhësore të nivelit A2.
- Motivimi dhe formimi i mësuesve të lëndëve të gjuhëve të huaja.
- Cilësia e teksteve të gjuhëve të huaja.
- Administrimi i mjediseve të provimit.